

Ac.nr.4525/14

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS , në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve K.M., Y.B. dhe H.M., që të gjithë nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson S.M., avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Sigal" në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit K.P., Jurist i diplomuar, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.883/2014, i datës 20.05.2014, në seancën jo publike të mbajtur me datë 06.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "Sigal" në Prishtinë, dhe VERTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 883/2014, i datës 20.05.2014, në pikën I (një) të dispozitivit, më përjashtim të pjesës se kërkesëpadisë lidhur me kamatën e gjykuar, në të cilën pjesë i njëjti aktgjykim NDRYSHOHET, ashtu që: paditësve ju gjykohet kamata vjetore të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 20.05.2014, e gjer në pagesën definitive.

II. Pika II (dy) e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar mbetet e paprekur.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.883/2014 i datës 20.05.2014, ka vendosur:

I.MIRATOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve K.M., Y.B. dhe H.M. që të gjithë nga Prishtina, DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "Sigal" në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit t'ua paguaj shumat si vijon:

I. a) Paditësit K.M. :

në emër të dëmit jo material:

- për dhimbje fizike, shumën prej 1.300 euro

- për frikën e pësuar, shumën prej 1.100 euro

në emër të dëmit material:

- për shpenzimet e shërimit, shumën prej4 euro

I.b) Paditësit Y.B. :

në emër të dëmit jo material:

- për dhimbje fizike, shumën prej1.300 euro

- për frikën e pësuar, shumën prej.....1.300 euro

në emër të dëmit material :

- për shpenzime të mjekimit, shumën prej 4 euro

I.c) Paditësit H.M. :

- për kompensim të dëmit material të shkaktuar në automjetin e markës Golf, ngjyrë të kaltër, me targa të regjistrimit XYZ-KS-XYZ, në shumën prej 1,136.35 euro.

Të gjitha këto me kamat vonese 3.5% si mjetet e deponuara mbi nj vit pa destinim të caktuar dhe atë nga data e marrjes së aktgjykimit 20.05.2014 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, bashkë me shpenzimet e procedurës në shumën prej 1,252.0 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

II.REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e gjykuara dhe atë për paditësin K.M., në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 2.700 euro, për frikën e pësuar shumën prej 1.900 euro, shpenzimet e mjekimit, shumën prej 16 euro, ndërsa në tërësi është refuzuar kërkesa për kompensim të dëmit material dhe atë në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 220 euro, rehabilitim fizioterapeutik, shumën prej 300 euro, si dhe ndihmës dhe kujdesit të personit të huaj shumën prej 300 euro, për paditësin Y.B. në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 2.700 euro, për frikën pësuar shumën prej 1.900 euro, për shpenzimet e mjekimit, shumën prej 16 euro, ndërsa në tërësi është refuzuar kërkesa për kompensimin e dëmit material dhe atë në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 220 euro, për rehabilitim fizioterapeutik shumën prej 300 euro, si dhe ndihmën dhe kujdesit të personit të huaj shumën prej 300 euro, SI E PABAZUAR.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, duke e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së shkallës së dytë, qe aktgjykimi i goditur të priset dhe çështja të kthehet ne rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur paditësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe gjeti se :

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre në gjykatën e shkallës së parë, kanë ushtruar padi kundër të paditurës, të cilën për se fundi herë i autorizuari i tyre e ka precizuar me parashtresën e datës 18.05.2011, më bazë kompensimin e dëmit material dhe jo material nga baza e auto përgjegjësisë, duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të dëmit jo material dhe material të cilin e kanë pësuar ne aksidentin e ndodhur me datën 26.09.2007 ne Prishtinë, Rr „ “, aksident ky i shkaktuar me fajin ekskluziv të të sigurvearit të paditurës, t’ju paguaj shumën e përgjithshme prej 17,285.50 euro, me kamatë ligjore duke llogaritur prej ditës se shkaktimit të dëmit e deri ne pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës sipas listës se shpenzimeve të prezantuar gjykatës, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes ne dorëzim të aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të palëve, e duke marrë për bazë edhe sugjerimet e dhëna nga Gjykata e Apelit sipas aktvendimit Ac.nr. 2790/12 i datës 12.03.2014, ka nxjerrë dhe administruar provat nga shkresat e lëndës, më vlerësimin e të cilave ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, ku edhe ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.882/2014, i datës 20.05.2014, duke vendos me decidivishtë si në dispozitiv të te njëjtit.

Lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se me provat e administruara gjykata ka vërtetuar se me datë 27.09.2007 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit ne rrugën „ “ ne Prishtinë, i shkaktuar me fajin e të sigurvearit të këtu të paditurës, i cili ne momentin e shkaktimit të aksidentit drejtonte veturën e markës BMW, me targa të regjistrimit XYZ-KS-XYZ, sipas polisës se sigurimit 000090538, i cili për shkak të mos mbajtjes se distancës se duhur ka goditur automjetin e tipit Golf , të cilin e ka drejtuar paditësit K.M., pronë e paditësit H.M., dhe pas kësaj për shkak të inercionit e ka goditur automjetin e tipit Audi, me traga të regjistrimit XYZ-KS-XYZ i cili ishte duke lëvizur para tij. Si pasojë e këtij aksidenti lëndime trupore kanë pësuar paditësit K.M. dhe Y.B. të cilët menjëherë kishin kërkuar ndihmë mjekësore ne Qendrën Emergjente në Prishtinë, ndërsa dëm materiale ishin shkaktuar edhe ne veturën , pronë e paditësit H.M..

Më tej gjykata ka arsyetuar se sa i përket bazës se kërkespadiës, sipas propozimit të palëve , e duke marrë për bazë edhe sugjerimet e dhëna nga Gjykata e Apelit sipas aktvendimit Ac.nr. 2790/12 i datës 12.03.2014 ka nxjerrë provën me ekspertim nga lëmi i komunikacionit e punuar me datë 26.09.2007 nga eksperti i komunikacionit Y.K., në bazë të se cilës ka konstatuar se shkaktar në aksidentin e ndodhur është ngasësi i veturës „ A “ e markës BMW, me targa të regjistrimit XYZ-KS-XYZ e siguruar tek e paditura , i cili është përgjegjës ekskluziv për lëndimet e shoferit dhe bashkudhëtarëve ne veturën „ B’ ‘, e markës WV Golf 1 HXO, me targa të regjistrimit XYZ-KS-XYZ pronë e paditësit H.M., e të cilën ditën kritike e drejtonte paditësi K.M., por edhe përgjegjës i vetëm edhe sa i përket dëmit material të shkaktuar ne pjesën e pasme të veturës të paditësit H., dhe atë për shkak të mos mbajtjes se distancës se sigurvearit prapa veturës „ B “ dhe lëvizjes me shpejtësi më të madhe dhe te pa përshtatshme. Ndersa për dëmtimin në pjesën e parë të veturës,, B’ ‘ pronë e paditësit H.M. , përgjegjës ne mënyrë të barabartë janë shoferi i veturës „ A “ i siguruar tek e paditura , por edhe vet drejtuesi i veturës „ B “, këtu paditësi K.M., për mos mbajtje të distancës se sigurvearit, si shkak i se cilës me pjesën e parë kishte goditur veturën „ C “ të markës Audi 8E A4, me targa të

regjistrimit XYZ-KS-XYZ, të cilën ditën e aksidentit e drejtonte personi i quajtur G.P.. Ekspertizës nga lëmi i komunikacionit , gjykata e shkallës së parë del te ja ketë falur besimin e plotë, duke vlerësuar s e njëjta është e qartë , e plotë , profesionale dhe ka mbeshtetje ne shkresat lëndore.

Sa i përket lartësisë se kërkespadi së lidhur me dëmin material të shkaktuar ne veturën,, B” , e markës WV Golf 1 HXO, me targa te regjistrimit XYZ-KS-XYZ pronë e paditësit H.M., gjykata ka nxjerrë provën me ekspertim nga lëmi i makinerisë e punuar nga eksperti i makinerisë R.SH., e datës 30.04.2014 në bazë te se cilës ka konstatuar se lartësia e dëmit të shkaktuar ne veturën e paditësit kap shumën e përgjithshme prej 1,454.30 euro. Mirëpo kur merret parasysh se sipas ekspertizës se komunikacionit përgjegjës ne mënyrë solidare apo në mënyrë te barabartë për dëmin e shkaktuar ne pjesën e parë te veturës se paditësit H.M. është drejtuesi i kësaj veture, këtu paditësi K. dhe i siguruari i te paditurës, dhe se vlera e dëmit në këtë pjesë te veturës kap shumën prej 635.90 euro, nën rrethanën e tillë gjykata duke marrë edhe kontributin e paditësit në këtë dëm te shkaktuar ne shkallën prej 50%, ka gjetur se e paditura për këtë dëm duhet te obligohet vetëm për 50 % te shkallës së përgjegjësisë se saj qe kap shumën prej 317.95 euro. Ndersa për dëmin e shkaktuar ne pjesën e pasme te veturës pronë e paditësit H.M. e cila kap shumën e përgjithshme prej 818.40 euro për të cilën i siguruari i te paditurës është shkaktar i vetëm duhet të obligohet ne tërësi, me çka kur mbledhim shumën e përgjithshme të dëmit rrjedh se e paditura është e obliguar qe te paguaj shumën prej 1,136.35 euro. Ekspertizës nga lëmi i makinerisë gjykata e shkallës së parë del te ja ketë falur besimin e plotë, duke vlerësuar s e njëjta është e qartë , e plotë , profesionale dhe ka mbeshtetje ne shkresat lëndore, e veçmas edhe ne ekspertizën nga lëmi i komunikacionit lidhur me ndarjen e përgjegjësisë në shkallën 50 % me 50% në mes paditësit K.M. dhe te paditurës, lidhur me dëmin e shkaktuar ne pjesën e përparme te veturës, pronë e paditësit H.M..

Sa i përket lartësisë se kërkesëpadi së lidhur më dëmin jo material të cilin paditësit K. dhe Y.B, e kishin pësuar ne aksidentin e ndodhur si shkak i lëndimeve trupore te pësuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se vendimin e saj e ka mbështetur ne dispozitën ligjore te nenit 200 al.1 të LMD, e duke marrë për bazë mendimin profesional të ekspertëve mjekësor të Dr.XH.S, ortoped-traumatolog dhe Dr.N.M., psikiatër, të cilët pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë bërë paditësve dhe shikimin te dokumentacionit mjekësor nga shkresat e lëndës, kanë konstatuar se:

Paditësi K.M. ne aksidentin e ndodhur kishte pësuar ndrydhje dhe përdredhje te qafës e shoqëruar me dhimbje krahë-qafë te dyanshme , të cilat karakterizohen si lëndime te lehta trupore. I njëjti ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej 30 minutave, dhimbje fizike te intensitetit të lartë 24 orë, të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh , ndersa te intensitetit të ulët ka edhe sot e asaj dite gjatë ngarkimit fizik dhe ndryshimeve klimatike. Ka pësuar frikë primare për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 24 orëve, frikë sekondare të intensitetit më të ulët në kohëzgjatje prej 2 muajsh.

Paditësi Y.B., si pasojë e aksidentit ka pësuar ndrydhje dhe përdredhje te qafës e shoqëruar me dhimbje krahë-qafë te dyanshme , të cilat karakterizohen si lëndime te lehta trupore. I njëjti ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej 30 minutave, dhimbje fizike te intensitetit të lartë 24 orë, të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh , ndersa te intensitetit të ulët ka edhe sot e asaj

dite gjatë ngarkimit fizik dhe ndryshimeve klimatike. Ka pësuar frikë primare për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 24 orëve, frikë sekondare të intensitetit më të ulët në kohëzgjatje prej 2 muajsh.

Mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor , gjykata e shkallës së parë ju ka falur besimin e plotë, duke vlerësuar se përmbajnë elementet e nevojshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, duke përfshirë edhe arsye të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve vendimtare sipas çështjes kontestimore ne fjalë.

Për kamatën gjykata e shkallës së parë ka vendosur konform nenit 186 dhe 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendimin e saj e ka bazuar ne dispozitën ligjore te nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së, e duke marrë për bazë suksesin e palëve ne procedurë dhe shpenzimet e nevojshme te cilat i kanë pasur për ndjekjen e çështjes s e tyre ne gjyq.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjendja faktike rezulton te jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë te drejtë nga gjykata e shkallës së parë, e cila lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar , qoftë sa i përket bazës se kërkesëpadisë por edhe lartësisë se saj, ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes sipas të njëjtit aktgjykim, e cila gjendje faktike edhe sipas gjykatës ankimore ka mbështetje ne provat nga shkresat e lëndës dhe ne ligj.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë më shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, më arsyetimin se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, në kundërshtim më vetveten dhe arsyetimin e dhënë dhe se në aktgjykimin e ankimuar nuk janë treguar arsyet lidhur me faktet vendimtare , sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se kjo gjykatë konstaton se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i përshtatshëm për përmbartim, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, ku në lidhshmëri me këtë edhe ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Të pathemelta qendrojnë edhe pretendimet e të paditurës për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes lidhur më çështjen kontestuese në fjalë, nga gjykata e shkallës së parë janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar ne procedurën kontestimore të udhëhequr tek gjykata e shkallës së parë.

Për më tepër pretendimi i të paditurës se me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar nuk ka marrë për bazë ndarjen e përgjegjësisë edhe sa i përket shumave te

gjykuara paditësit K.M. dhe Y.B. në emër të dëmit jo material te shkaktuar, ashtu siç ka vendosur lidhur më dëmin material te shkaktuar ne veturën e paditësit H.M., sipas kësaj gjykate është tërësisht i pathemeltë, për faktin se me analizimin dhe vlerësimin e ekspertizë se komunikacionit e punuar nga Y.K., të cilës gjykata e shkallës së parë ja ka falur në tërësi besimin, e të cilës ja fal besimin edhe kjo gjykatë pasi që konsideron se është mjaft e qartë, konstatohet se përgjegjës ekskluziv dhe i vetëm për lëndimet të cilat ditën e aksidentit u janë shkaktuar paditësve K. dhe Y.B., është i siguruari i te paditurës M.G. i cili atë ditë ishte duke drejtuar veturën e markës BMW 346 me targa te regjistrimit XYZ-KS-XYZ, me çka mbi bazën e një provë te tillë qartë rrjedh se lidhur më këtë lloji dëmi të gjykuar nuk kemi fare të bëjmë me ndarje te përgjegjësisë ne mes te siguruarit te të paditurës dhe këtu paditësve K.M. dhe Y.B., pasi që të njëjtit fare nuk kanë kontribuar ne shkaktimin e këtij dëmi.

Sa i përket të drejtës materiale lidhur me përgjegjësinë e të paditurës që e njëjta t'ia kompensojë paditësit lidhur më dëmin material dhe jo material të shkaktuar, të cilin e kanë pësuar në aksidentin e komunikacionit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit sipas dispozitës së nenit 154,178, 185 dhe 195 të LMD-së, e lidhur me nenin 13 dhe 18 parg. të 1 Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve të cilat i kanë pësuar paditësit, e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit si natyra e dhimbjeve fizike, lloji dhe intensiteti i frikës dhe rrethanat tjera, rezulton se shumata e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmit që kanë pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

I pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i te paditurës edhe sa i përket pretendimit lidhur me shpenzimet procedurale të gjykuara paditësve, pasi që paditura si palë e cila ka humbur kontestin gjyqësor ne kuptim te nenit 452.1 të LPK-së, ka për detyrim që paditësve si palë gjyq fituese t'ua shpërblej shpenzimet gjyqësore, ku shpenzimet e njohura paditësve nga gjykata e shkallës së parë me shikimin ne shkresat e lëndës rezulton se janë në përputhje të plotë me shpenzimet e nevojshme që paditësit kanë pasur gjatë procedurës për ndjekjen e çështjes në gjyq, e që i referohen shpenzimeve lidhur me përfaqësimin e paditësve në procedurë nga i autorizuari i tyre, taksave gjyqësore për padi dhe aktgjykim, si dhe nxjerrjen e provave me ekspertim nga lëmi mjekësor, lëmi i makinerisë dhe lëmia e komunikacionit.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket kamatës se gjykuar , Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar, duke u mbështetur ne dispozitën e nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqë lidhur më këtë pjesë të kërkesëpadisë ka gjetur se është zbatuar në

mënyrë të gabuar dispozita e ligjit material, neni 277 i LMD-së, pasi që kamata nuk është përcaktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë ligjore.

Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk është shqyrtuar fare nga e kësaj gjykate, pasi që aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë nuk është goditur nga pala ankuese.

Nga arsyet e cekura, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), e lidhur me nenin 200 dhe 201 pika (d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.4525/14, me datë 06.11.2018

Kryetari i kolegjit
Qerim Ademaj, d.v.